




REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KUÇOVË
DREJTORIA E URBANISTIKËS DHE STREHIMIT



Nr. Prot. 339

Kuçovë, më 09/02 2016

Lënda: Dërgohët dokumenti i Strategjisë Territoriale për marrjen e Aktit të Konformitetit

Drejtuar: Znj. Adelina Greca
Drejtore e Përgjithshme
Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit
Adresa: Rruga "Muhamet Gjollësia", Nr.57, Tiranë

E nderuar Znj. Greca,

Bashkia Kuçovë, në bashkëpunim me Agjencinë e Shteteve të Bashkara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID), përmes Projektit për Planifikimin dhe Qeverisjen Vendore (PLGP) dhe me asistencën e "Institutit për Zhvillimin e Habitatit - CoPlan" është në procesin e hartimit të Planit të Përgjithshëm Vendor për territorin e bashkisë së re Kuçovë. Gjatë këtij procesi janë realizuar konsultime të shumta me grupet e interesit, dëgjesa publike mbi nismën e hartimit të PPV, analizën dhe strategjinë territoriale në datat 09.10.2015, 04.12.2015 dhe 13.01.2016. Dokumentacioni i nevojshëm është publikuar në RIT (Regjistri i Integruar i Territorit) sipas përcaktimeve ligjore.

Pas përfundimit të procesit të hartimit të gjithë materialit, në zbatim të ligjit 107/2015 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit", i ndryshuar, neni 9, "Përgjegjësitë e Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit", neni 23 "Bashkërendimi, këshillimi dhe shqyrtimi publik i dokumenteve të planifikimit", si dhe në mbështetje të VKM nr. 671, datë 29.07.2015 "Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit", neni 59 germa 'a' dhe 'b', lutemi të shpreheni në lidhje me konformitetin e Strategjisë Territoriale.

Bashkangjitur gjeni CD me materialin e hartimit të Strategjisë Territoriale në version elektronik.

Me respekt

KRYETARI I BASHKISË

Selfo KAPLLANI

